



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI PORTUAL DURRËS  
DIVIZIONI JURIDIK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Për: OE “2AF Albania Group” shpk NIPT L32005501M**

**Adresa:** DIBËR, Bulqizë, Fshati Vajkal NR1 Nr. pasurie 2310, Zone Kadastrale 3694, volumi 10, faqe 116

Procedura e prokurimit: “Procedurën e Hapur” – Mallra- Marrëveshje kuadër

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-10471-11-05-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Materiale Elektrike**” 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes kuadër.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 163 datë 15 Nëntor 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik „2AF Albania Group“ sh.p.k. me NIPT L32005501M - me vlerë 10.720.400 ( dhjetë milion e shtatëqind e njëzet mije e katërqind) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik „Luan Spahija“ me NIPT L01807503L - me vlerë 10.708.850 ( dhjetë milion e shtatëqind e tetëmijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik „SARK“ sh.p.k. me NIPT K52531415H - me vlerë 9.607.000 ( nëntë milion e gjashtëqind e shtatë mijë ) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori Ekonomik „Luan Spahija Spahija“ me NIPT L01807503L - me vlerë 10.708.850 ( dhjetë milion e shtatëqind e tetëmijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH. OE nuk plotëson asnjë nga kërkesat e DST. OE ka dorëzuar vetëm ofertën ekonomike e cila nuk është në përputhje me formatin e kërkuar në DST sipas LPP-së.

OE „Luan Spahija Spahija“ me NIPT L01807503L nuk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në Dokumentat e Tenderit, për këte arsye AK vendosi të mos e kualifikojë këtë ofertë.

- Operatori Ekonomik „SARK“ sh.p.k. me NIPT K52531415H - me vlerë 9.607.000 ( nëntë milion e gjashtëqind e shtatë mijë ) lekë pa TVSH.

- Nga evidentimi i dokumentave të paraqitura nga OE "SARK" evidentohen mangësi apo mosplotësim të kërkesave të DST si më poshtë:

1. Mosplotësim i pikës 2.3.4 i DST. OE ka paraqitur 2 autorizime nga prodhuesi/distributori zyrtar "Sali Elektrik" për autorizim shitje kabëll elektrik (1 prej artikujve të kërkuar në pikën 2.3.4) dhe autorizim për shitje ndricues (artikull që nuk kërkohet në pikën 2.3.4). Ndërkohë mungojnë autorizimet për shitje të 3 artikujve të tjerë kërkuar në pikën 2.3.4 të DST Kriteret të Vecanta të Kualifikimit si : Cele 630A 20KV; Paketë Kontrolli Rifazatorëve; Celësa elektronik Trifast.

2. Mosplotësim i pikës 2.3.5 të DST Kriteret të Vecanta të Kualifikimit pasi katalogët e paraqitur nga OE nuk dokumentojnë të gjithë mallrat e kërkuar nga kjo procedurë prokurimi dhe nuk janë katalog të autorizimeve të firmës prodhuese ose distributor zyrtar ku autorizohet OE ofertues në këtë procedurë prokurimi.

3. Mosplotësim i pikës 2.3.6 të DST kriteret të Vecanta të Kualifikimit pasi oferta teknike e paraqitur nga OE "SARK" në dokumentin me emërtesë "Deklaratat A.P.Durrës" faqja 19 e fundit, nuk përputhet me përmbajtjen dhe formatin e ofertës teknike ngarkuar në sistemin e APP pjesë e DST kërkuar nga AK. Kjo pasi OE ka ngatërruar formatin dhe nr. e zërave të kërkuar në pikën 2.3.7 për sjellje mostrash pranë AK me ofertën teknike e cila përmban 26 zëra dhe tjetër format e përmbatje afishuar online në APP pjesë e DST kërkuar nga AK.

4. Mosplotësim i pikës 2.3.7 pasi OE ka pasur afat limit kohe deri në orën 11:00 datë 06.12.2021 për të dorëzuar mostrat e kërkuara nga AK sipas tabelës në pikën 2.3.7 në protokollin e AK dhe nuk i ka dorëzuar asnjë nga mostrat.

OE „SARK“ sh.p.k. me NIPT K52531415H nuk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në Dokumentat e Tenderit, për këte arsye AK vendosi të mos e kualifikojë këtë ofertë.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“2AF Albania Group” shpk NIPT L32005501M**, dhe me adresa: DIBËR, Bulqizë, Fshati Vajkal NR1 Nr. pasurie 2310, Zone Kadastrale 3694, volumni 10, faqe 116, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 10.720.400 ( dhjetë milion e shtatëqind e njëzet mijë e katërqind) lekë pa TVSH, është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Pirro Vengu**